



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 25. 11. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Adelina Krasniqi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Lulzim Rustemi, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës

3. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shendetesise
7. Feti Krasniqi, Drejtor i BPZHR
8. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
9. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
10. Avni Olluri, Drejtor i DGJK
11. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
12. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
13. Vlora Krasniqi, shefe e zyres ligjore
14. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
15. Bekim Krasniqi, "YAHR"
16. Bukurije Zejnullahu, zyra për informim
17. Përfaqësuesit e mediave
18. Numër i konsideruar i qytetarëve
19. Naser Bytyqi, perkthyes shqip-serbisht
20. Bajram Zaskoku

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Sami Murati.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se para se të kalojmë në punë sipas rendit të ditës më lejoni t'i them disa fjalë lidhur me fushatën vetëdisuese "ndal dhunën ndaj gruas". Sot është dita e parë e kësaj fushate që do të zgjatë deri me 10 dhjetor.

Ju po e shifni se sot salla e Kuvendit është më ndryshe e stolisur me fjonga të bardha edhe pse nuk është seancë solemne, andaj na mund ta shfrytëzojmë që në ditën e parë të kësaj fushate bashkarisht si delegatë të Kuvendit të bëjmë thirrje për respekt të ndërsjelltë dhe barazi gjinore jo vetëm në familje por edhe në shoqëri. Ka plotë thënje të mëdha por unë do ta veqoja një thirrje ku është thënë: Na jep gruan e shkolluar dhe të edukuar mirë unë do ta jap shtetin.

Në vazhdim njoftoi Kuvendin se sot kemi një anëtarë të ri të Kuvendit Lulzim Rustemin i cili vjen në vend të Ragip Zejnullahut i cili ka dhënë dorëheqje dhe ftoj anëtarin e ri për dhënje të betimit. Pastaj Lulzim Rustemi në vazhdim dha betimin duke lexuar deklaratën solemne. Në vazhdim Kryesuesja i uroj punë të mbarë anëtarit të ri Lulzim Rustemit.

Në vazhdim Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni, bëri leximin e rendit të ditës së propozuar dhe pastaj pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka dikush vërejtje apo plotësime.

Merita Zeqiri-Hajrizi, unë kërkoj që në rendë dite të futet edhe një pikë – një deklaratë kundër asociacionit të komunave dhe demarkacionit me Malin e Zi. Ne si grup parlamentar i AAK-së dhe W nuk mund të jemi indiferent ndaj këtyre të padrejtave që po i ndodhin shtetit tonë. Të gjithë e dijme se për këtë tokë është derdhur gjak dhe nuk kemi tokë t'i falim askujt, andaj kërkoj nga LDK dhe PDK të përkrahin këtë pikë.

Vlora Limani-Hajnuni, rreth pikës që propozoj Merita unë po e shprehi mendimin tim se asociacioni dhe demarkacioni nuk janë në kopetencën e Kuvendit dhe unë kam obligim që propozimin ta qes në votim dhe Kuvendi vendos a me shqyrtu apo jo.

Pastaj vuri në votim propozimin e Meritës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicë votash refuzoi që kjo pikë të hynë në rend ditës.

Pastaj vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e KK-së
2. Propozim Vendim për vazhdimin e Vendimit të KK Lipjan 1Nr.465-168 të dt. 13.04.2004 për shfrytëzim të sipërfaqës së paluajtëshme.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për ri-integrim
4. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan Këshillit të Bashkësisë Islame për ndërtimin e objektit për të pame në fshatin Rufc i Ri
5. Propozim Vendim për anulimin e vendimit të KK Lipjan 1Nr.464-162 të dt. 12.02.2009 dhe shkëputjen e kontratës 1Nr.464-508 dt. 02. 06. 2009 për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore në ZK Ribar i Vogël
6. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacioneve distributive në fshatrat Bregu i Zi, Rufc i Vjetër dhe Sllovi.
7. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan për varreza në fshatin Babush i Muhaxherëve
8. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
9. Informatë e DBPZHR lidhur me fushatën e korrje-shirjeve për vitin 2015 në Komunën e Lipjanit si dhe përgatitjet e mbjelljeve vjeshtore

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi pyeti anëtarët se a ka dikush të shtroj diqka.

Merita Zeqiri-Hajrizi, së pari ju falenderoj të gjithëve që nuk e përkraht pikën që e propozova dhe e di që po poletizoheni nga qendra por kjo do të jetë në ndërgjegjjen e juaj. Pastaj dashta ta pyes Drejtorin e Arsimit se si është e mundur që në qendër ku janë dy shkolla njëra të ketë psikolog kurse tjetra jo e që në shkollën tonë kemi 1000 nxënës e nuk kemi psikolog.

Labinot Shahini, kam dy qështje që kemi diskutu edhe në Komitetin për Shërbime Publike. E para është shqetësimi i qytetarëve të rruga 4 korsi ku janë shtruar kupzat për me hyp automjetet në trotuar dhe kjo ka marrë një pamje të shëmtuar dhe për këtë është i njoftuar edhe Drejtori. Si qështje e dytë është nxjerrja e Rregullores për Shërbime Publike.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së edhe më herët kemi kërku që mbledhjet e Kuvendit të përcillen nga një televizion lokal dhe jo vetëm mbledhjet e Kuvendit por edhe të Komiteteve të Kuvendit. Shqetësim tjetër është nga qytetarët e Gadimes ku në mëngjes nuk ka transport për bartjen e nxënësve deri te shkolla e gjithashtu bartja e nxënësve për mësim pas dite bëhet një orë më heret. Në rrugën "Ilirida" është prer rruga në tri vende nga Kompania e ujësjellësit e gjithashtu në një vend është pre edhe gypi i ujit dhe uji rrjedh pa ndërpre.

Në Shalë ndriqimi publik nuk është funksional dhe kërkoj nga DSHP që ta funksionalizoj ndriqimin publik.

Në Vërshevc mësuesja ka shkuar në pushim të lehonise dhe që një javë nxënësit kanë mbetur pa mësim.

Linda Shahini, unë kam kërkesën e qytetarëve që kanë kërkuar ndërrimin e emërave të rrugëve dhe është mirë që rrugët të kenë edhe nga një numër.

Hajrije Salihu, nga Komuna është publiku lista e punëtorëve arsimor të cilët nuk e kanë paguar tatimin dhe këtë listë e kanë prurë në shkollë qka konsideroj se ky është nënqimim për arsimtarët-profesorët.

Nehat Tërpeza, unë kam pyetje për Drejtorin e arsimit lidhur me trafostacionin te shkolla "Kadri Beba" në Ribar që është prish që disa kohë dhe qka është ndërmarrë për këtë.

Ramiz Qeriqi, kam vërejtje në ekstrakt meqë unë kam thënë punëkryersi i oborrit të shkollës nuk i ka kryer si duhet punët dhe uji vërshon nga rruga, kurse në ekstrakt është thënë punëkryersi i rrugëve nuk i ka kryer punët si duhet, andaj kërkoj që të përmirësohet në ekstrakt. Shqetësim tjetër është i banorëve të lagjes Jeta e Re meqë betonjerka i pengon shumë nga një erë e rëndë dhe këtë e kam vërtetuar vet dhe kërkesa është bërë nga ata banor në Komunë dhe nuk e di a është shqyrtu ajo kërkesë. Lagjja tjetër me shqipëtarë në Grackë të Vjetër nuk është përfshi me ndriqim publik, andaj kërkoj që edhe kjo lagje të përfshihet me ndriqim publik. Kam pasur edhe kërkesa tjera që i kam përmendur në Kuvend siqë është ndarja e banesave, kërkesa për mbylljen e kazinove dhe pagesa për Qerdhen e fmijëve dhe nuk kam marrë përgjigje për këto kërkesa.

Enver Kozhani, është shqetësim i qytetarëve meqë në disa rrugë të disa fshatrave nuk janë tabelat që tregojnë hyrje në fshat, andaj është mirë që këto tabela të vëhen në hyrje të fshatrave dhe në fund të fshatrave .

Qështja e dytë ka të bëjë lidhur me përfundimin e fazës së dytë të asfaltimit të rrugëve në fshatin Ribar i Madh dhe na intereson se cilat rrugë kanë përfundu, cilat rrugë janë 4 metra e cila 3 metra. Gjithashtu është një kërkesë i një numri të vogël të qytetarëve për nxënësit të cilët nuk kanë përfunduar tetëvjeqaren dhe kërkojnë që të organizohet mësimi shtesë në një shkollë të Komunës në mënyrë që këta nxënës ta përfundojnë shkollën fillore.

Lulzim Rrustemi, propozoj që në mbledhjen e ardhshme të hynë në rend dite shqyrtimi i raportit të punës të Komiteteve.

Zoran Çirkoviq, në mbledhjen e kaluar kam kërku që te shkolla fillore Braqa Aksiq në Lipjan ku vijojnë mësimin nxënësit nga komuniteti serb që të shtrohet një pjesë e rrugës e cila nuk është më e gjatë se 100 metra dhe ate nëse ka mundësi që të shtrohet në këtë vit. Qështje tjetër është që te parku që është rregullu te Kisha të rregullohet qeshmja dhe ndriqimi. Gjithashtu në Grackë të Vjetër në objektin e ish Kooperativës Bujqësore i cili është privatizu është duke punuar diqka dhe askush nuk e dijmë se qka punohet aty, andaj është mirë që inspektorati të konstatoj se qka është duke u punuar aty dhe të njoftohen qytetarët.

Pastaj tha se në Grackë të Vjetër janë duke u ndërtuar mure të oborreve dhe konsiderojm se gjatë ndërtimit të tyre ka edhe uzurpime të pronës shoqërore, andaj është mirë që inspekcioni t'i kontrolloj këto.

Blerim Gashi, unë po e përseriti një pyetje të cilën e kam bërë edhe në vitin e kaluar lidhur me përfundimin e objektit të dhënë me koncesion ku ky objekt është dashtë të kryhet para 3 viteve dhe ende nuk është përfunduar andaj kërkoj sqarim nga Drejtori i Urbanizmit.

Valbona Shillova, unë kam shqetësimin për shëndetësinë ku qytetarët e fshatit Shalë dhe Gadime kanë shpreh shqetësimin e tyre se stamatologët në këto qendra mjekësore nuk punojnë ashtu siqë është e paraparë me orar por vetëm nga 3-4 orë në ditë.

Rasim Hasani, sa u përket psikologëve nëpër shkolla është dëshirë e jona që të kemi psikolog në qdo shkollë, por dëshira dhe mundësit nuk janë të njejta dhe për një kohë nuk kemi mundësi t'i plotësojmë këto vende. Rreth transportit të nxënësve në Gadime na e kemi angazhu një autobus të vogël dhe Gadimja është e madhe ndoshta ka nevoj edhe për dy autobusa por këto kanë qenë mundësitë. Për Vërshevc ne e kemi shpall konkursin por jemi vonuar meqë nuk e ka lajmëruar pushimin e lehonisë me kohë. Për publikimin e listës për obliguesit tatimor na e kemi qu listën dhe nuk është Vendim i yni por është obligim ligjor dhe tatimi duhet të paguhet. Për trafo në Ribar kemi probleme me KEDS-in dhe për këtë është angazhuar edhe Kryetari por ende nuk është zgjidhur ky problem. Për mësimin shtesë për ata që nuk e kanë kryer tetëvjeqaren mësimi është pa pagesë.

Sa i përket pagesës në Qerdhe unë e kam raportin dhe mund ta kqyrim se kush ka paguar dhe kush nuk ka paguar.

Hajrije Salihu, unë nuk e mora përgjigjen adekuate dhe pyes Drejtorin se publikimi i asaj liste për obliguesit tatimor a është shkelje e privatësisë.

Ilir Tasholli, po filloj me pyetjen e Blerimit lidhur me përfundimin e objektit të eurokosit dhe e njoftoj se tani ky objekt është në përfundim e sipër.

Sa i përket ankesave për emërtimin e rrugëve kjo ka qenë pjesë e legjislativit të kaluar dhe ka qenë një proces shumë i shpejt ku kanë qenë 600 emërtime të rrugëve dhe pas përfundimit të emërtimeve e kemi parë se ka pasur lëshime dhe kemi shumë ankesa që ju kanë drejtuar DPU-së. Në shumë raste janë hjek tabelat e rrugëve dhe këtë qështje do ta inicojmë për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend.

Rasim Hasani, të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e kanë marrë listën e obliguesve tatimor dhe si ka mundësi që vetëm punëtorëve të arsimit të ju preket dinjiteti.

Avdullah Fazliu, ishte pyetja për punën e stamatologëve në Shalë dhe Gadime për shkak të mospërfilljes së orarit të punës dhe ju njoftoj se në QKMF është kutija për ankesa dhe na nuk kemi marr asnjë ankesë për këtë qështje. Për furnizim me thengjill të QKMF-së është nënshkru kontrata dhe së shpejti do të furnizohet.

Heset Sahiti, te rruga 4 korsi është duke u rregullu shtrurja me kupza dhe aty ku janë kriju pengesa do të hiqen pengesat. Për Rregulloren për Shërbime Publike për momentin nuk ka Ligj por për këtë qështje por kemi ligjin për mbeturina dhe do ta nxjerrim edhe Rregulloren. Për ndriqimin publik në Shalë e kemi përzgjedhë kompaninë për mirëmbajtjen e ndriqimit publik dhe besoj se edhe ndriqimi publik në Shalë do të rregullohet. Sa i përket ujësjellësit, kompania po duhet me intervenu dhe po ndodh prerja e asfaltit dhe kjo kompani ka obligim që ta kthej në gjendje të mëparshme rrugën mirëpo në shumë raste këto punë po naj len neve. Për shenjëzime për fshatra në rrugët regjionale është kopetencë e nivelit qëndrorë e jo komunal. Në Ribar të madh janë asfaltu 4 rrugë dhe prej tyre dy janë me gjërësi 4 metra kurse dy janë me gjërësi me 3 metra.

Enver Kozhani, rrugët që i përmenda për shenjëzim nuk janë regjionale por komunale. Te rruga “Agim Bllaca” në Ribar ka filluar me 4 metra gjërësi dhe ka përfunduar me 3 metra e gjithashtu edhe te lagja Rama është e njejtë.

Petrit Kelmendi, pyeti se a është parashtrur ndonjë kërkesë në Ministri për rrugën Lipjan-Magurë pasi që kjo rrugë është e nivelit regional dhe është dëmtuar shumë dhe është mjaft e frekuentuar.

Sefer Tasholli, Nënkyetar, po i drejtohem Zoranit dhe po i them se për objektin e Kooperatives Bujqësore kopetent është AKP-ja e jo Komuna. Për rrugën te shkolla do të përpiqemi që këtë vit ta zhavorojmë. Për tatimin në pronë Ministria e Financave ka marr Vendim për t'i njoftu të gjithë tatim paguesit për shkak të faljeve të borxheve. Për rrugën Magurë – Lipjan kemi bërë kërkesë dhe është parapa me Buxhet të Kosovës për vitin e ardhshëm.

Pasi pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Kuvendit?

Daut Azemi, unë kam një vjerejtje në ekstrakt në faqen 8 ku është thënë Adelina Krasniqi duhet të jetë Angjelina Krasniqi e gjithashtu në faqen 12 ku thuhet në Babush një arsimtar i ka pasur 2 asistente dhe është e kundërta se 2 mësuese e kanë pasur 1 asistente.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuesi, në faqen 10 te pika e 5 e rendit të ditës ku thuhet Kuvendi aprovoi këtë Vendim të qitet titulli i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim ekstraktin me vërejtjet e cekura më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave

Aprovoi
Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 22-të të Kuvendit me vrejtitet e cekura më lart

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendim për vazhdimin e Vendimit të KK Lipjan 1Nr.465-168 të dt. 13.04.2004 për shfrytëzim të sipërfaqës së paluajtëshme

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, këtë Vendim e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe kemi konstatu se sigurimi i këtij objekti është në nivelin më të lartë dhe na e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar në KPF i kemi ngrit shqetsimet tona dhe kompania që e ka parashtrur kërkesën e ka pasur në shfrytëzim këtë pronë për 10 vite dhe afati i ka skadur në vitin 2014 dhe pyes Drejtorin se a ju ka tërhequr vërejtja kësaj kompanie për shkak të skadimit të afatit. Në vazhdim tha se kjo depo nuk është e monitoruar nga niveli qëndror dhe strukturat e sigurisë ndërkombëtare që janë këtu meqë e dijmë se në një rast kur janë ndezë disa mbeturina në afërsi të depos menjëherë ka intervenu KFOR -i.

Kur ju ka dhënë prona në shfrytëzim kësaj kompanie atëherë ka qenë baza ligjore tjetër dhe prona nuk është dalë në tender kurse tani ka ndryshuar Ligji dhe me Ligj prona që ipet në shfrytëzim duhet të dalë në tender mirëpo ky ju ka ikur procedurave. Gjithashtu ne nuk e dijmë se cili është interesi i Komunës, sa punëtorë punëson kjo kompani nga Komuna e jonë.

Ilir Tasholli, në KPF e kemi shqyrtu këtë Vendim dhe i njeiti është përkrah nga të gjithë.

Është e vërtetë se Komuna i ka dhënë tokën në shfrytëzim për 10 vjet dhe e njëjta kompani e ka ndërtuar objektin dhe është i vetmi objekt në regjionin e Komunës tonë dhe të Prishtinës.

Sa i përket sigurisë aty janë dy objekte ku në njërin objekt është eksplozivi dhe në tjetrin detonatorët qka do të thotë se edhe nëse ndizet eksplozivi nuk mund të ketë detonim dhe se siguria e këtyre objekteve është në nivelin më të lartë. U pyet pse nuk është dalë në tender kjo pronë dhe arsyeja që nuk është dalë në tender është se është e njëjta kompani dhe është duke ushtruar funksionin e vet.

Florent Hoxha, Drejtori u mundu me e arsyetuar këtë propozim Vendim por nuk na dha përgjigjen që kërkoja unë. Kompania e ka pasur në shfrytëzim këtë pronë për 10 vite me Vendim të Kuvendit dhe afati i ka kaluar mbi 1 vit e gjysëm, andaj kjo kompani e ka shfrytëzuar pronën një vit e gjysmë pa kurrfarë procedure. Drejtori e tha që është i njeiti pronarë dhe për këtë e kemi bërë propozim për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës por ne e dimë se është ndërruar titullari. Pastaj tha se me kontratë Kryetari i ka dhënë në shfrytëzim pronat dhe më vonë Komuna ka shkëputë ato kontrata meqë ka ndryshuar Ligji dhe mendoj se Ligji vlenë edhe për këtë rast.

Ilir Tasholli, replikë nuk kam listë se sa punëtorë janë aty dhe nuk e njoh fare këtë pronarë. Pastaj i njoftoj me interesat që ka Komuna.

Blerim Gashi, kjo pronë është dhënë në shfrytëzim në vitin 2004 dhe nëse atëherë ka qenë ligjore nuk kemi arsye mos me ja dhënë edhe sot. Në fund kërkoj që të gjitha vendimet

për dhënien në shfrytëzim të pronave të rishqyrtohen në mënyrë që të dimë se sa janë realizu ato vendime.

Lulzim Rustemi, këtu kemi të bëjmë një qështje shumë të rëndësishme që edhe biznesi është i rëndësishëm. Këtu janë dy qështje që ngrejn dilema prendaj edhe na grupi pazrlamentar i PDK-së kemi dilema;

E para është se shfrytëzuesi i pronës është vonu 1 vit e disa muaj pa arsye dhe

E dyta kjo është SH.P.K, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e nuk është Agjension Shtetnor që me fitu pronen me kushte të veqanta dhe dispozitat ligjore kanë ndryshu në krahasim me vitin 2004. Iliri përmendi se ka disa punëtorë por ne nuk i dijmë detajet specifike dhe nuk i dijmë interesat vitale të Komunës. Për t'ia vazhduar edhe për 10 vite kjo nuk është e lehtë por edhe me votu kundër nuk është lehtë se është investu aty.

Xhevat Olluri, u shtru pyetja se a ka Komuna interes, Komuna nuk ka interes vetëm për punësimin e disa punëtorëve por këtu është një biznes dhe normal që Komuna ka interes nga bizneset dhe nëse nuk ka pasur ndonjë shkelje kjo kompani dhe i ka përmbush të gjitha obligimet konsideroj se nuk ka nevojë me shpallë ankand publik.

Petrit Kelemendi, unë pajtohem me Florentin dhe dokumentacioni duhet të plotësohet në mënyrë që të dijmë se a i ka përmbushur obligimet si ndaj Komunës ashtu edhe ndaj nivelit qendror.

Sefer Tasholli, Nënkryetar, Ligji për dhënien e pronave në shrytëzim për rastet e veqanta e parasheh pa marrë vendim paraprak në Kuvend dhe pa tenderim dhe ky është një rast i veqant dhe në këto raste në Kuvend mund të merret Vendim drejtëprësdrejt dhe këtë e parasheh neni 10 i Ligjit. Pastaj tha se ky objekt është i mbikqyrur nga Ministria e Punëve të Mbrendshme dhe nëse e ka sjellë vertetimin nga MPM për marrje të pëlqimit na nuk kemi nevojë me e tenderu këtë pronë se kjo kompani i plotëson kushtet.

Florent Hoxha, Nënkryetari e arsyetoi mirëpo në bazë të dokumentacionit që e kemi konsideroj se nuk është bindës për ta aprovuar këtë Vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për 10 kundër 1 apstenim aprovoi këtë:

VENDIM

PËR VAZHDIMIN E VENDIMIT TË KK LIPJAN 1NR.465-168 TË DT.13.04.2004 PËR SHFRYTËZIM TË SIPËRFAQES SË PALUAJTSHMERISË

Neni 1

VAZHDOHET për 10 vite Vendimi i KK Lipjan 1Nr.465-168 i dt.13.04.2004, për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan në Babush të Muhaxherëve me sipërfaqe prej 0.50,00 ha, në pjesën e ngastrës kadastrale: P-71409059-00562-1 në vendin e quajtur "Balkan" me kulturë kullosë e kl.V-të me sipërfaqe të përgjithshme prej 21.16,66 ha e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan, ish N.P.K "Tropikana Minervo", tani "Tropicana A&L Mining" Sh.p.k nga Ferizaj.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër, që të ndërmarrë të gjitha veprimet në lidhje me procedurën e regjistrimit në librat publike, KK Lipjan, shfrytëzues për 10 vite "Tropicana A&L Mining" Sh.p.k nga Ferizaj.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik dhe DGJK-Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Në ora 12,00 Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13,00

Pas pauzës në ora 13,30 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së tretë

III

Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për ri-integrim

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajlit Drejtor i Administratës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit si dhe Plani i veprimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Linda Shahini, ne grupi parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë Plan dhe të njëjtin e përkrahim.

Florent Hoxha, edhe ne grupi parlamentar i PDK-se e kemi shqyrtu këtë Plan dhe është një plan i mirë por unë kam një vërejtje aty ku thuhet fuqizim i kapaciteteve duhet të thuhet ngritja e kapaciteteve. Në vazhdim pyeti se me këtë plan a ka implikime buxhetore dhe nëse po atëherë pes se a janë planifiku me buxhet për vitin 2016. Në vazhdim tha se në këtë plan nuk përfshihet vetëm niveli lokal por edhe niveli qendror dhe na si grup parlamentar e përkrahim.

Blerim Gashi, edhe na e përkrahim këtë plan dhe është një obligim që na marrim obligim nga niveli qendror. Unë nuk e di që me buxhet për vitin 2016 kemi parapa mjete lidhur me këtë plan.

Fauz Xhemajli, ajo qka po ngrite këtu për implikimet buxhetore na e kemi zyrën për kthim dhe integrim që u ndihmon njerëzve, mirëpo për ndërtim na nuk kemi obligim.

Hajrije Salihu, na kemi disa komunitete që janë shpërngul dhe dashta të pyes se gjatë riintegrit a do të ketë diskriminime pozitive ndaj ndonjë komuniteti.

Xhevat Olluri, me sa po e shoh unë më duket se mund të ketë implikime buxhetore dhe kemi familje që kanë shitë pronën dhe pyes se qka do të bëhet me ato familje që do të kthehen.

Fauz Xhemajli, na kemi nda planin e integrit dhe planin e riatëdhësimit dhe këto plane kanë kriteret e veta.

Ramiz Qeriqi, me sa po e kuptoj unë na gjithmonë kemi favorizu të huajt (shkit dhe magjupt).

Fauz Xhemajli, plani është integruar që përfshin interesat e gjitha grupeve dhe përfshinë periudhën 1999- 2010 dhe nuk është plan vetëm për një komunitet.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, 3 apstenime aprovoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RI-INTEGRIM

Neni 1

MIRATOHET , Plani Lokal i Veprimit për Ri-integrim .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani Lokal i Veprimit për Ri-integrim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

IV

**Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK
Lipjan Këshillit të Bashkësisë Islame për ndërtimin e objektit për të pame në fshatin
Rufc i Ri**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashanit Drejtor i DRKS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ramiz Qeriqi, nuk e di se a është marrë pëlqimi nga banorët për ndërtimin e objektit aty dhe unë konsideroj se ky vend është mirë të ruhet për diqka tjetër.

Burbuqe Fazliu, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe të njejtin e përkrahim.

Hajrij Salihu, edhe na e përkrahim këtë propozim Vendim dhe kërkojmë që këto objekte mos të emërtohen vetëm për të pame por edhe aktivitete tjera e gjithashtu edhe për femra.

Lulzim Rrustemi, mua më pëlqej propozimi i Luanit dhe kjo kërkesë është legjitime por lokacioni nuk është me vend dhe është mirë që këtë lokacion me e ruajtë për qështje tjera meqë aty janë 5 hektarë dhe për këtë objekt është dashtë të vijnë 2-3 propozime dhe 5 ari janë shumë dhe mjaftoj 3-5 ari. Në fund propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Arben Bahtiri, na e kemi aprovu një kërkesë të tillë edhe më parë për një fshat që nuk e di për cilin fshat, mirëpo në rajonin e Dugagjinit të pamet janë ndal e që sigurisht një të ardhme jo të largët do të ndodh edhe te ne, andaj është mirë që këtij objekti t'i bashkangjitet edhe një bibliotekë.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, te destinimi është problem të ndrrohet meqë parashihet me Ligj destinimi dhe nuk kemi drejtë ta ndrtysojmë.

Labinot Shahini, pyeti se a është kërkesë e qytetarëve për dhënien e kësaj prone apo vetëm e BI dhe nëse është e Bashkësisë Islame na nuk mund ta ndërrojmë destinimin. Këto shqetësime që u ngriten është mirë me shty këtë pikë meqë na nuk po e dijmë se sa Bashkësia Islame është marrë me qytetarët dhe a janë të pëlqimit ata se kjo është një pozitë shumë e mirë për t'u ruajtur për diqka tjetër a dihet se BI paraprakisht i shiqon vendet më të mira për këto raste.

Feriz Hasani, këto objekte është mirë që të ndërtohen afër Xhamive.

Petrit Kelmendi, nga banorët nuk është marrë kurrfarë pelqimi dhe këto kërkesa është mirë të mirret drejtëpërsëdrejti nga qytetarët.

Agron Hajdini, në bazë të këtyre që u thanë është mirë që të përcillet një mesazh te qytetarët se na nuk jemi kundër këtij Vendimi por kërkojmë sqarime shtesë.

Xhevat Olluri, unë mendoj se kërkesat për nevojat e qytetarëve duhet të vijnë nga këshilli i fshatit dhe propozoj që kjo pikë të shtyhet për të ardhmen.

Nazmi Krasniqi, kjo pikë është shqyrtuar në KPF dhe e kemi përkrah, mirëpo tani sipas diskutimeve po shihet aty qenka një hapsirë e mirë dhe është mirë që ajo hapsirë të ruhet kurse për këtë objekt mund ta caktojmë një hapsirë tjetër.

Avni Olluri, Drejtor GJK, tha se këto kërkesa vijnë prej këshillave të fshatrave përmes BI për shkak të procedurave, mirëpo meqë tre përfaqësues të atij lokaliteti propozuan që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim për të ardhmen edhe unë jam që të shtyhet kjo pikë.

Lulzim Rrustemi, Drejtori e tha se proceduralisht vetëm BI mund ta merr në shfrytëzim dhe na nuk po e kontestojmë këtë por vetëm po propozojmë që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme meqë ka edhe vende tjera për këtë destinim.

Ramiz Qeriqi, krejt po e dinë por nuk po e thonë se pas ndërtimit të këtij objekti BI aty ka me ndërtu një Xhami.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, tha se kërkesa është bërë nga Këshilli i fshatit te BI dhe destinimin nuk mund ta ndryshojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja pyeti anëtarët se kush është që ky propozim i Vendimit të shtyhet për shqyrtim për një seancë tjetër.

Pas votimit Kryesuesja konstatoi se Kuvendi me 27 vota për vendosi që ky propozim i Vendimit të shqyrtohet në një seancë tjetër.

Shtesë: propozimi i Vendimit.

V

Propozim Vendim për anulimin e vendimit të KK Lipjan 1Nr.464-162 të dt.12.02.2009 dhe shkëputjen e kontratës 1Nr.464-508 dt. 02. 06. 2009 për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore në ZK Ribar i Vogël

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, ne si grup parlamentar i LDK-se e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e përkrahim, njëherit e përgëzojmë ekzekutivin për një hap të tillë dhe si grup parlamentar kemi kërkesë që të gjitha vendimet ku kemi dhënë prona në shfrytëzim e që nuk i kanë përmbush kontratat kërkojmë që ato vendime të rishqyrtohen.

Ramiz Qeriqi, është një hap i mirë dhe propozoj që në të ardhmen pronat që janë dhënë te QMI-a dhe aty ku nuk kanë punuar fare t'u anulohen vendimet.

Enver Kozhani, edhe na grupi parlamentar i PDK-se e kemi shqyrtu këtë vendim dhe të njëjtin e përkrahim.

Adelina Krasniqi, gjithashtu edhe na e përkrahim këtë propozim vendim dhe me këtë vendim prona i kthehet titullarit të mëparshëm.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KK LIPJAN 1NR.464-162 TË DT.12.02.2009 DHE
SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1NR.464-508 DT.02.06.2009 PËR DHËNIEN NË
SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE NË ZK RIBAR I VOGËL

Neni 1

1.ANULOHEM Vendimi i KK Lipjan 1-464-162 të dt.12.02.2009, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan në ZK Ribar i Vogël me sipërfaqe prej 2.00,00 ha, NTP "Endriti" Fadil Humolli nga Prishtina, për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e etanolit (alkool) bujqësor në pjesën e ngastrave kadastrale: P-71409052-00312-1 në vendin e quajtur "Selo" me kulturë kullosë e kl.2-të me sipërfaqe prej 1.51,07 ha (sipërfaqe e përgjithshme prej 3.57,76 ha) dhe P-71409052-00314-0 në vendin e quajtur "Selo" me kulturë kullosë e kl. 2-të me sipërfaqe prej 0.48,93 ha (sipërfaqe e përgjithshme prej 2.90,21 ha) ZK Ribar i Vogël, P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan.

2.SHKËPUTET Kontrata 1Nr.464-508 dt.02.06.2009, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh të pjesës me sipërfaqe prej 1.51,07 ha nga ngastra kadastrale P-71409052-00312-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3.57,76 ha, dhe sipërfaqes prej 0.48,93 ha nga ngastra kadastrale P-71409052-00314-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.90,21 ha ZK Ribar i Vogël, P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacioneve distributive në fshatrat Bregu i Zi, Rufc i Vjetër dhe Sllovi.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendime dhe ky vendim ka të bëjë me interesin e qytetarëve, andaj edhe e përkrahim.

Rizah Bajraktari, edhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim.

Florent Hoxha, unë e kam të pakjartë ku në vendim thuhet pasuri e rrugëve dhe nuk e di se Komuna a ka të drejtë me dhënë në shfrytëzim meqë është pasuri e rrugëve. Na si grup parlamentar e përkrahim.

Lulzim Rustemi, në preambullë të Vendimit është gabuar ku thuhet te neni 3.3 e që ky nen ka të bëjë për Bashkësinë Islame a për rastin konkret duhet të jetë neni 20. pika 11 e Rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Ukë Kryeziu, unë e përkrahu këtë propozim Vendim mirëpo aty ku thuhet për 99 vite duhet të shikojmë se KEDS-i kontratën nuk e ka për 99 vite dhe është mirë që afati i dhënies në shfrytëzim t'i ipet aty sa e ka kontratën KEDS-i.

Avni Olluri, Luli pati të drejtë ku tha se në preambullë te neni 3.3 është gabim dhe duhet të jetë neni 11 sa i përket vërejtjes së Florentit kur tha se është pronë e rrugëve me Ligj thuhet se me rrugët lokale qeverisë Komuna dhe nuk ka pengesë për dhënien në shfrytëzim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me vërejtjen e Lulzim Rrustemit që në preambullë të vendimit 3.3 të zavendsohet me nenin 11 të Rregullores për dhënen në shfrytëzim të pronave dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE PËR VENDOSJEN
E TRAFOSTACIONEVE DISTRIBUTIVE NË FSHATRRAT BREGU I ZI, RUFC I VJETËR
DHE SLLLOVI

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 99 vite, toka-Pasuri Shoqërore KEDS-it sh.a Divizioni i shpërndarjes Prishtinë, për vendosjen e Trafostacioneve distributive të fuqive 100 kVA, 630 kVA dhe 250 kVA në pjesët e ngastrave kadastrale:

- P-71409038-01726-0 në vendin e quajtur “Brenosh” me sipërfaqe prej 100m² (sipërfaqe totale prej 223953m²) e evidentuar në Certifikatën nr.3855/2015 ZK Kraishtë,P.Sh e Kuvendit Komunal Lipjan .

- P-71409081-00559-0 në vendin e quajtur “Trshivina” me sipërfaqe prej 100m² (sipërfaqe totale prej 9407m²) e evidentuar në Certifikatën nr.3855/2015 ZK Rufc i Vjetër, Pasuri Shoqërore e Rrugëve.

- P-71409077-01560-2 në vendin e quajtur “Podleske” me sipërfaqe prej 9m² (sipërfaqe totale prej 1217m²) evidentuar në Certifikatën nr.4129/2015 ZK Slllovi,Pasuri Shoqërore e Rrugëve.

Neni 2

Pronat e përshkruara në nenin 1 të këtij Vendimi, respektivisht sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e trafostacioneve i ipen në shfrytëzim për periudhën prej 99 viteve, KEDS-it sh.a Divizioni i shpërndarjes Prishtinë, me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, furnizimin e banorëve me energji elektrike, dhe përmirësimin e tensionit të rrymës elektrike sipas standardeve të parapara teknike.

Neni 3

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas marrjes së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtoratin për Urbanizëm,Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parceliazimin e sipërfaqeve të cilat ipen në shfrytëzim dhe të njëjtat t'i regjistrojnë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë për 99 vite, Kompanisë KEDS.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan për varreza në fshatin Babush i Muhaxherëve

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, për këtë Vendim është kërkesë e drejtpërdrejt e qytetarëve të Babushit përmes Bashkësisë Islame. Ne e dijmë se më herët ka qenë një vendim i mëhershëm i Kuvendit për caktimin e lokacionit për varreza por si fshat nuk e kemi shfrytëzu atë lokacion për shkak se aty është afër rezervuari i ujit të pijshëm, andaj kemi kërku ndërrimin e këtij lokacioni dhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, edhe më herët kur është marrë Vendimi për caktimin e lokacionit për varreza ka qenë kërkesë e qytetarëve dhe BI dhe ate dy familje e kanë kundërshtu atë lokacion, andaj ne si grup parlamentar e përkrahim propozim Vendimin.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

1.IPET në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Babush i Muhaxherëve toka-Pasuri Shoqërore KK Lipjan me sipërfaqe prej 1.00,00 ha nga pjesa e ngastrës kadastrale P-71409059-00559-0 në vendin e quajtur “Balkan” me sipërfaqe të përgjithshme prej 25.99,45 ha me kulturë kulllosë e kl.4-të ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan.

2.SHFUQIZOHET Vendimi KK Lipjan 1Nr.464-590 i dt.28.05.2010 për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan për varreza në fshatin Babush i Muhaxherëve në pjesën e ngastrës kadastrale P-71409059-00546-0 me sipërfaqe prej 1.00,00 ha ZK Babush i Muhaxherëve, Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër, që të ndërmarr të gjitha veprimet në lidhje me procedurën e regjistrimit në librat publike të pjesës së ngastrës-00559-0 me sipërfaqe prej 1.00,00 ha me kulturë “Varreza” ZK Babush i Muhaxherëve, shfrytëzues për 99 vite Këshilli i Bashkësisë Islame Lipjan.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik dhe DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VIII
Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare
Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashani, Drejtor i DRKS, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, tani po shihet se nuk ka nevojë ta arsyetojmë këtë Vendim dhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim dhe kërkojmë nga DSHP që të nxjerr Rregulloren për mënyrën e pagesës së këtyre mjeteve.

Ramiz Qeriqi, na edhe më herët kemi thënë që të nxirret një Rregullore se edhe hoxhollarët po bijnë si lypsar. Gjithashtu ceku se kemi edhe komunitete fetare tjera dhe shtrohet pyetja si do t'i marrin ata këto mjete.

Linda Shahini, është mirë që Komuna po i hjek shpenzimet e varrimit por konsideroj që ka edhe keqpërdorime të këtyre mjeteve që është për keq ardhje.

Burbuqe Ilazi, edhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim.

Nazmi Krasniqi, pajtohem që këto mjete të shfrytëzohen si duhet dhe kërkoj që BI të paraqet raport për shpenzimet e këtyre mjeteve.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për miratoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË
ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 6600 €, (gjashtë mijë e gjashtëqind euro), për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 60 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur prej datës 18.08.2015 deri më 27.10.2015 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 60 = 6600$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2015.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shesë: Vendimi.

X

Informatë e DBPZHR lidhur me fushatën e korrje-shirjeve për vitin 2015 në
Komunën e Lipjanit si dhe përgatitjet e mbjelljeve vjeshtore

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Feti Krasniqit Drejtor i DBPZHR i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Vlora Buja, e tha edhe Drejtori se kjo informatë është e vonuar por edhe pse e vonuar na jep një pasqyrë lidhur me korrije shirjet si dhe sipërfaqet e planifikuara për të mbjellurat vjeshtore.

Ali Stublla, Drejtori përmendi sipërfaqet e mbjellura, korrije shirjet e gjithashtu përgatitjet për mbjelljet vjeshtore por nuk e përmendi fare dëmet të cilat shkaktohen nga vërshimet nga Lumi Sitnica.

Nazmi Krasniqi, Drejtori paraqiti një raport por nuk besoj që sipërfaqet që përmendi që janë të sakta. Në vazhdim tha se edhe subvencionet janë duke u keqpërdorur.

Daut Azemi, Drejtori përmendi se 4 hektar grur i'u janë djegur Shaban Reçicës nga Topliqani dhe dashta të pyes se a i është ndihmu diqka nga Komuna.

Ramiz Qeriqi, pyeti se për fatëkeqësitë natyrore a ka ndonjë ndihmë për bujqit dhe blegëtorët.

Enver Kozhani, pyeti se a ka ndonjë kontrollë për cilësinë e farërave dhe përmbajtja e plehrave a është e sakt.

Blerim Bashi, ne e kemi një plan të zhvillimit ekonomik lokal dhe pyes a keni bërë mjaft për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në bazë të këtij plani.

Florent Hoxha, është një informatë e mirë nga Drejtori i Bujqësisë dhe na si Kuvend e kemi planin e zhvillimit ekonomik lokal dhe pyes se a jemi duke e zbatu atë plan. Drejtori e përmendi se korrije shirjet kanë shkuar mirë mirëpo disa kombaja e tha edhe Drejtori kanë qenë të mira dhe nuk kanë rrjedh grurin por unë e di se disa kombaja të tipit ZMAJ e rrjedhin shumë grurin, andaj është mirë që Drejtorati para korrije shirjeve nëse ka ekspert t'i kontrolloj ato kombaja në mënyrë që të eliminohen lëshimet.

Në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit u përgjigj Drejtori i DBPZHR.

Mbleldhja përfundoi në ora 15,³⁰

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni***